


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	21/10/2013
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RASHITI Drejtor i Prokurimit në QKUK
CC:	z. Nijazi GASHI Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për Tenderin: "Servisimi dhe Mirëmbajta e Pajisjeve Radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë "

Të nderuar!

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin "Servisimi dhe Mirëmbajta e Pajisjeve Radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë " me nr.prokurimi:701-13-075-211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues, që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Servisimi dhe Mirëmbajta e Pajisjeve Radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë ", në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Qendra Klinike Universitare e Kosovës, duke u bazuar në nevojën e Servisimit dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve Radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë ka paraparë procedurë të hapur prokurimi për këto shërbime.

Më datë **08/06/2012** ka bërë “Njoftim për Kontratë” me numër Prokurimi: 701-12-104-211 e cila nuk ishte e ndarë në lote dhe në “Specifikimin Teknik” nuk ishin paraparë pjesë rezervë kryesore.

Më **13/06/2012** Autoriteti Kontraktues ka bërë “Shtyrja e afatit” dhe më pas ka shpallur “Njoftim Anulimi” me datë 14/09/2012, për shkak se vetëm njëri nga tre OE ishte i përgjegjshëm.

Më **19/12/2012** AK – QKUK publikon sërish “Njoftim për Kontratë” me numër prokurimi: 701-12-104-211.

Pas ankese se bere ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me datën 25/01/2013, nga njeri prej operatorëve ekonomik, OSHP me Vendimin PSH.nr. 14/2013 te datës 21.02.2013 Urdhëron Autoritetin Kontraktues ta kthej në Ri-Tenderim këtë procedurë Prokurimi dhe me rastin e ri-shpalljes së tenderit, të ndahet aktiviteti i prokurimit në **Lote**.

Autoriteti Kontraktues QKUK përmes parashtresës me nr. të protokollit 14/2013 të datës 11/02/2013, e ka njoftuar Panelin Shqyrtues se nuk pajtohet me konstatimet dhe rekomandimet për ndarjen në Lote të aparaturave radiologjike për servisim, me arsyetim profesional se aparaturat dhe pjesët e tyre përbëjnë një tërësi (**Aparatet Radiologjike + printerët + RIS-ISSA**) dhe ndarja e tyre është joracionale dhe jo e realizueshme. Ngase këto pajisje janë te prodhuara nga prodhuesi **“SIEMENS-e”** dhe ne si autoritet kontraktues jemi të obliguar ti paraqes ne dosje dhe ti njoftoje operatorët e interesuar se çfare lloje aparatura janë dhe gjendjen momentale te tyre për këtë aktivitet te prokurimit.

Agjencia kundër Korrupsionit **konsideron**, se OSHP ka kërkuar nga AK-QKUK të ndajë servisimin e aparaturave radiologjike në lote pa bërë asnjë vlerësim, krahasim dhe ekzaminim të gjendjes së këtyre aparaturave të cilat i posedon QKUK.

Kështu që me datën 05/03/2013 Autoriteti Kontraktues - QKUK bazuar në vendimin e OSHP-së me nr: 14/2013 të datës 21/02/2013 ka bërë **“Njoftim Anulimi”**

Autoriteti kontraktues QKUK me datën 16.05.2013 ka shpallur tender Servisimit dhe Mirëmbajtjen e Pajisjeve Radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë dhe ka ndare servisimin e pajisjeve ne loto ku krahas kësaj ka bere edhe ndryshimin e kërkesave te përshtatshmërisë profesionale nga shpalljet e mëparshme. Konkretisht ne “Dosjen e Tenderit” Seksioni II FTD tek pika 7.1 te Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale QKUK ka kërkuar

Autorizimi nga prodhuesi vetëm për Lot 4 për shkak se nevojitet leja për qasje në serverin bazë – (njëri OE nëse janë grup i OE).

Në provat shkresore që posedon AKK të një komunikimi elektronik të datës 15/05/2013 në mes të Shefit të Radiologjisë dhe Zyrtarit të prokurimit në QKUK ku në këtë komunikim zyrtar bien dakord që për kritere për servisim dhe mirëmbajtje të aparaturave radiologjike të kërkohej vetëm certifikatat e serverëve për mirëmbajtje dhe servisim të aparaturave radiologjike. Ndërsa vetëm për **lot.4 (Serveri ISSA)** duhet të kërkohej autorizim i prodhuesit për shkak se nevojitet leja për qasje në server.

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë hetimit dhe mbledhjes së dokumentacionit për këtë tender ka arritur të sigurojë këto tri dokumente me nr: njësi 1.4 dhe protokolli, 05-5828 të datës 17.12.2009, 148 të datës 29.12.2009, nr: njësi 09 dhe nr: protokolli 05-5828/2 të datës 30.12.2009 në të cilat kemi informata zyrtare rreth pranimi të donacionit të ofruar nga operatori ekonomik për Ministrinë Shëndetësisë. Në raportin shtesë të pajisjeve të liferuar si donacion nga kompania “Medica” në Radiologji –QKUK, në faqe numër 2 figurojnë këto programe (**softwar-i**): **ISSA SERVER, DICOM SERVER, PHAROS SERVER, ISSA NS MM, ISSA NS, ISSA 3D/VC, ISSA FRONT DESK.**

Në vazhdimësi të hetimit AKK posedon dokumentacion si dëshmi se kur janë blerë këto pajisje, nga cili prodhues, listën pjesëve rezerve (kryesore) të këtyre aparaturave radiologjike dhe kushteve tjera të kontratave të kontraktuar për këto furnizime. Në komunikim zyrtar me prodhuesin Agjencia Kundër Korrupsionit posedon dokumentacion se kush është përfaqësues i prodhuesit **“SIEMENS” për Kosovë**, andaj shtrohet pyetja si do të qasen këtyre aparaturave operator të cilët nuk posedojnë Autorizimin nga prodhuesi i pajisjeve !?

Agjencia kundër Korrupsionit vie në përfundim se Qendra Klinike Universitare e Kosovës si Autoritet Kontraktues gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit dhe specifikimeve teknike nuk ka vepruar drejtë dhe koforme Ligjit të Prokurimit dhe për pasojë kemi një proces të **stërzgjat**ur dhe me shumë **probleme**.

Kështu që më datë 21/05/2013 Operatori Ekonomik “Medbrand Sh.p.k” përmes adresës elektronike ka bërë kërkesën për “Dosjen e Tenderit” ndërsa më datë 30/05/2013 ka bërë kërkesë edhe për informacione shtesë për

Sipas kompanisë ankuese, Autoriteti Kontraktues - QKUK nuk ka kërkuar **Autorizimin** nga prodhuesi për pajisjet kryesore radiologjike, që janë pajisjet më të rëndësishme të këtij projekti. Sipas “Med Brand” autorizimi nga prodhuesi duhet të kërkohej edhe për Lotet:1.2.3.5.6.7.8 sepse edhe për Lotet tjera nevojitet leja për qasje dhe vetëm kompania e autorizuar nga prodhuesi mund të ketë qasje në këto pajisje.

Më që kërkesa e “Med Brand Sh.p.k” nuk është përfillur nga **AK-QKUK**, operatori ekonomik në fjalë ka vendosur që ankesën ta adresoj në **OSHP** më datë **14/06/2013**.

Më datë 26/06/2013 Organi Shqyrtues i Prokurimit pas shqyrtimit të ankesës të datës 14/06/2013 përmes **“Konkluzion”** P.SH.nr183/2013 urdhëron AK-QKUK që për çdo LOT të kërkojë autorizimin nga prodhuesi për aktivitetin e prokurimit “Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve radiologjike për Qendrën Diagnostike dhe Institutin e Onkologjisë”. Autoriteti Kontraktues QKUK

pas “Konkluzion”-it të OSHP-së ka bërë ndryshimin në “ Dosja e Tenderit” dhe në “Njoftim për Kontratë (korrigjim dhe shtyrje afati)” të publikuar në KRPP me 28/06/2013 tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale ku ne piken 7.1. Autorizim nga prodhuesi te kërkohet për të gjitha lotet – (njeri OE nëse janë grup i OE).

Autoritetit kontraktues ne dosjen tenderit për serivisim vendos kërkesën e përshtatshmërisë profesionale për qasjen e autorizuar nga prodhuesi për aparaturat te cilat i posedon dhe fillon me procesin e vlerësimit, AKK merre pjesë ne vlerësim cilësinë e vëzhguesit.

Dosjen e tenderit e kane tërhequr edhe disa operator brenda dhe jashtë Kosovës por ofertat e tyre nuk i kane dërguar me arsyetim se ne nuk jemi përfaqësua për servisim të aparaturave të cila janë prezantuar në dosjen e tenderit.

Kështu qe komisioni vlerësues gjate vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit te ofertave te tre operatorëve konkurrues te cilët kane konkurruar për këto loto ka vërejt se autorizimet e prezantuar nga operator konkurrues janë te ndryshme (autorizim nga prodhuesi apo te përfaqësuesve te tyre), njëherë është bere një krahasimi i çmimit ofertues ku kemi një rritje te çmimit te ofertave prej vlerës se parashikuar te kontratës prej 800.000.00 deri ne 1.400.000.00 dhe duke rritur çmimin e ofertës .

Operatorët te cilët kane dorëzuar ofertat e tyre ne loto përkatëse dhe me vlerën totale te ofertave te tyre janë:

1.MEDBRAND me **1.213.000,00€** (për Lot: 1,2,3,5,6,7,8,10,11,12,13,14 &15)

2.Made Kos me **206.100,00 €** (Për Lot: 4 & 9) .

3.Medica me **611.570,00€** (për Lot: 1,2,3,4,5,6,8 & 9)

Gjate procesit te vlerësimit, te tenderit ne ofertën e prezantuar nga Operatori Ekonomik (Medica) hasim dokument me shkrim sipas të cilit prodhuesi “SIEMENS” nuk prodhon pjesë rezervë të kërkuara në tender, dhe se autorizim nuk lëshon kjo kompani. Më kërkesë të Komisionit të Vlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga prodhuesi “SIEMENS” nëse vërtetë nuk ofrojnë pjesë rezervë dhe autorizim, në lidhje me pajisjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, përgjigja e SIEMENS ishte se adresa e emailit që iu është drejtuar, nuk është adresë zyrtare. Nga Autoriteti Kontraktues na u është thënë se ata do ti drejtohen sërish “SIEMENS”-it me email zyrtar dhe pas kësaj, ne si AKK nuk kemi informacion shtesë a është proceduar ky email dhe a iu është dhënë përgjigje e duhur nga SIEMENS.

Komisioni vlerësues gjate punës se vete ka identifikue se njëri nga OE ka konkurruar si konzorcium me një OE tjetër i cili po ashtu është në pronësi të tij. D.m.th në njërin kompani është drejtor, ndërsa tek tjetra administrator. Pra, në marrëveshjen e përbashkët që kanë aplikuar në tender, i njëjti person është nënshkruer i dokumentit të bashkëpunimit. Komisioni i Vlerësimit ka kërkuar nga KRPP sqarim në lidhje me këtë kontest, ku KRPP iu është përgjigjur se kjo nuk përbën ndonjë shkelje ligjore.

Kështu qe me datën 12/09/2013, AK-QKUK sipas vendimit të “Komisionit për Vlerësimin e Ofertave” bënë “Njoftim Anulimi” me arsyetimin se 1. Një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit ku për Lotet 1,2,3,5,6,7,8,10,11,12,13,14,15 kemi vetëm një (1) OE të përgjegjshëm kurse Loti 4 dhe 9 anulohet me rekomandimin e komisionit për vlerësim e ofertave, **sepse Loti 4 dhe 9 janë programe të punës për lotet e tjera.**

Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Agjencia kundër Korrupsionit gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të ofruar është vënë re se në dy vitet (2012-2013) vlera e "Deklaratës së Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve" ka qenë **800.000,00 €** ndërsa vlera e ofertave e Operatorëve Ekonomik. për këtë tender (të shpallur disa herë) ka qenë: Për vitin 2012 Medica me **958.800,00€** dhe Made Kos me **1.084.500,00€**; ndërsa për vitin 2013: 1.MEDBRAND me **1.213.000,00€** (për Lotet: 1,2,3,5,6,7,8,10,11,12,13,14 &15) 2. Made Kos me **206.100,00 €** (Për Lot: 4 & 9) , 3. Medica me **611.570,00€** (për Lot: 1,2,3,4,5,6,8 & 9) .

Andaj Agjencia Kundër Korrupsionit duke e parë ecurinë e kësaj procedure të prokurimit e sheh të nevojshme që të mbajë kontakte të rregullta zyrtare me prodhuesin e aparaturave të cilat do të servisohen gjatë aktivitetit të ri të prokurimit. Njëherë në do të jemi pjesë e punës në çdo fazë të këtij aktiviteti të prokurimit duke përfshirë monitorimin dhe menaxhimin e kontratës për servisim

AKK rekomandon AK(QKUK) që këtë procedurë prokurimi ta realizoj përmes procedurës së negociuar, drejtpërdrejtë me prodhuesit e aparaturave. **Ky rekomandim vjen në shprehje duke analizuar ecurinë e kësaj procedure prokurimi.** Prej mjeteve të planifikuara nga AK-QKUK prej 800.000.00 €, ofertat e OE kanë arritur shumën mbi 1.400.000,00 €. Konsiderojmë se është në interes të ruajtjes së parasë publike dhe ligjshmërisë.

AKK rekomandon që të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Me respekt!